

NEW BRIDGES

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2017
- Statusi Ligjor: Organizatë joqeveritare,
- Selia Qendrore: Lagjja "18 Tetori", Ura Vajgurore, Dimal, Berat
- Faqja e Internetit: www.newbridgesngo.org
- Email kryesor i organizatës: uratereja@gmail.com
- Telefoni kryesor i organizatës: +355693577652

2. Misioni

Të rrisim pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën ekonomike, sociale dhe mjedisore, përmes edukimit qytetar, nismave avokuese dhe iniciativave konkrete që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe me bazë qytetare

3. Vizioni (Opsionale)

Komunitete të përfshira, të barabarta dhe të qëndrueshme, ku çdo qytetar ka zë dhe rol në ndërtimin e një të ardhmeje të drejtë dhe të qëndrueshme për njerëzit dhe natyrën.

4. Fushat Kryesore të Fokosit

- Ndërgjegjësim dhe edukim
- Iniciativa avokuese dhe komunitare
- Fuqizimi i grave dhe barazia gjinore
- Angazhimi i të rinjve dhe vullnetarizmi
- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

- **Projekti "Berati, qytet i gjelbëruar dhe rini e ndërgjegjësuar" (2021–2022)**
– Finacuar nga GreenAL/SIDA. Trajnime dhe fushata ndërgjegjësimi për ruajtjen e pyllit në malin Partizan, mbjellje pemësh dhe pastrime në lagje me pjesëmarrje rinore.
- **Projekti "Transformimi social–ekologjik në qarkun Berat" (2022)**
– Finacuar nga Friedrich Ebert Stiftung. Seminare ndërsektoriale me aktorë lokalë mbi drejtësinë klimatike dhe veprime për uljen e ndikimit të ndryshimeve klimatike në sektorët ekonomikë në nivel vendor.
- **Projekti "Të Advokojmë për Mbrojtjen e Mjedisit" (2021)**
– Finacuar nga Friedrich Ebert Stiftung . Edukim joformal për të rinjtë mbi temat mjedisore dhe avokim për miratimin e një rregulloreje për ndotjen e ajrit në nivel vendor.

6. Shtrirja Gjeografike

Organizata “New Bridges” operon kryesisht në qarkun e Beratit, duke zbatuar projekte në bashkitë Berat, Dimal, Kuçovë, Skrapar dhe Poliçan, në zona urbane dhe rurale. Megjithatë, aktiviteti i organizatës nuk është i kufizuar vetëm në nivel lokal. New Bridges ka zbatuar projekte dhe ka ndërmarrë bashkëpunime edhe në bashki të tjera jashtë qarkut të Beratit, si në Roskovec, Fier, dhe Tiranë, si dhe ka marrë pjesë në inisiativa kombëtare dhe rrjete me ndikim më të gjerë. Kjo i jep organizatës një profil aktiv jo vetëm në nivel vendor, por edhe në nivel kombëtar, veçanërisht në fushat e edukimit qytetar, pjesëmarrjes rinore dhe mbrojtjes së mjedisit.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Zoica Doci Bardhi

Bordi i Drejtuesve: Arjana Maci, Valbona Mata, Daniel Xhardo, Stela Miha, Laurent Bardhaj.

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

- Donatorë dhe partnerë kryesorë: European Endowment for Democracy, AKR, AWEN, GreenAL, Friedrich Ebert Stiftung, Leviz Albania, Kongresi Rinor Kombëtar, COSV, USAID/ANTTARC, AMSHC etj.
- Bashkëpunim aktiv me bashkitë e qarkut Berat, shkolla të mesme, qendra rinore dhe institucione lokale dhe kombëtare.
- Anëtare e Kongresit Rinor Kombëtar dhe bashkëpunuese me rrjete vendore për pjesëmarrje qytetare dhe qeverisje të mirë.

9. Ndikimi (Opsionale)

- Më shumë se 2,000 të rinj janë përfshirë në aktivitete edukimi, pjesëmarrje qytetare dhe ndërgjegjësim mjedisor.
- Rreth 1,500 pemë janë mbjellë në kuadër të fushatave komunitare për gjelbërim dhe mbrojtjen e natyrës.
- Janë zhvilluar inisiativa advokuese në nivel vendor, veçanërisht mbi përmirësimin e shërbimeve publike, buxhetimin me pjesëmarrje dhe përfshirjen e të rinjve dhe grave në vendimmarrje.
- Është vërejtur rritje e dukshme e ndërgjegjësimit për drejtësinë klimatike dhe ndotjen e ajrit në komunitetet e qarkut Berat.